

LËVIZJA MAJTISTE E SHQIPËRISË 1920- 1939

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË

NGA

AVDYL RASHICA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

DHJETOR, 2022

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

Mentori: *Prof. Asoc. Dr. Selim Bezeraj*

Kandidati: *Avdyl Rashica*

Tema: *Lëvizja majtiste e Shqipërisë 1920- 1939*

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: "Lëvizja majtiste e Shqipërisë 1920- 1939", ndërsa synimi është për të paraqitur një shpjegim të qartë të lëvizjes së majtë në Shqipëri gjatë viteve 20'- 30'. Janë të shtjelluara ngjarjet e kësaj lëvizje në mënyrë kronologjike duke përfshirë ngjarjet më të njohura që pati kjo lëvizje, depërtimi i ideve, shfaqja e tyre në Shqipëri, si gjetën zbatim, politikat e majta të qeverisë së Nolit, organizatat e majta që u hapën në migracion, celulat dhe grupet e majta shqiptare, politikat e BRSS-së në Shqipëri, ballafaqimin e shtetit shqiptar ndaj kësaj lëvizje e deri tek formimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë .

Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim. Ndërsa më pas ka ndodhur strukturimi i temës e cila është e ndarë në 5 kapituj dhe në disa nënkapituj, të cilave u paraprijnë: abstrakti, parathënia (ku shpjegohen qëllimet, metodat, pyetjet hulumtuese dhe hipotezat), lista e grafikeve, e shkurtesave dhe hyrja.

Kapitujt kanë këtë përmbajtje strukturore:

1. Në kapitullin e parë të titulluar: "LËVIZJA E MAJTË GJATË VITEVE 1920-1924", fillojmë me depërtimin e ideve të majta tek shqiptarët, personalitetet e para që sollën këto ide brenda Shqipërisë, duke vazhduar me shpërfaqjen e këtyre ideve në kuvendin shqiptar. Përveç kësaj flasim edhe për interesimin e BRSS-së për të shtirë ndikimin në Shqipëri, lidhjet e saja me opozitën dhe pozitën e kohës e duke vazhduar deri te qeverisja e Nolit.
2. Në kapitullin e dytë të titulluar: "FORMIMI DHE VEPRIMTARIA E GRUPEVE KOMUNISTE NË SHQIPËRI", flasim për shpërbërjen e Grupin Komunist Shqiptar të Bashkimit Sovjetik, veprimtarinë e të dërguarve të Kominternit në Shqipëri dhe për grupet më të njohura komuniste në atë vend si dhe në fund të këtij kapitulli për përpjekjet për formimin e partisë komuniste

3. Në kapitullin e tretë të titulluar: " FORMIMI I ORGANIZATAVE TË MAJTA NË MËRGIM DHE VEPRIMTARIA E TYRE 20'-30' ", flas për formimin e organizatave në mërgim si KONARE dhe GKSHBS. Aty është trajtuar mënyra e formimit të tyre, përbërjes, veprimtarinë e tyre, lidhjet me Bashkimin Sovjetik, etj..
4. Në kapitullin e katërt të titulluar "PËRFSHIRJA E TË MAJTËVE NË ORGANIZATA, GREVA, KRYENGRITJE DHE LUFTËRA GJATË VITEVE 30' ", kam trajtuar përfshirjen e të majtëve në lëvizjen fshatare e sindikaliste gjatë viteve 30', politikat e tyre për të i bërë për vete fshatarët dhe punëtorët, pastaj për përfshirjen e tyre edhe në kryengritjet më të njohura të asaj kohe.
5. Në kapitullin e pestë të titulluar "ÇËSHTJA E BRENDSHME ORGANIZATIVE DHE PLATFORMA E RE E INTERNACIONALES", kam sqaruar karakteristikat e lëvizjes komuniste gjatë viteve 1934- 1939, duke folur për veprimtarinë e tyre, organizimet, ardhjen e platformës së re të Kominternit dhe shtrirjen e saj e duke vazhduar me arrestimet e bëra ndaj komunistëve dhe pozicionimin e tyre në prag të pushtimit fashist, ndërsa në fund kam folur edhe për masat që ndërmoi shteti shqiptar ndaj kësaj lëvizje.

Në punimin e kësaj teme sa i përket metodave hulumtuese janë përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Ndërsa për të finalizuar temën janë përdorur metodat përshkruese, analitike dhe krahasimtare. Gjithashtu për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar një sërë burimesh arkivore të cilat janë marrë nga Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), burime arkivore të botuara, punime shkencore, etj., të cilat më kanë ndihmuar në vërtetimin e hipotezave të ngritura, të cilat janë:

1. Idetë e majta erdhën në Shqipëri nga jashtë. Idetë e para të majta ishin socialiste ndërsa më pas erdhën ato komuniste.
2. Bashkimi i grupeve komuniste nuk u bë përshkak dallimeve ideologjike, inateve, dëshira për të dominuar njëri mbi tjetrin dhe lidhjet që kishin me organizatat e tjera të majta jashtë Shqipërisë.
3. Lëvizja e majtë dështoi të lidhet me fshatarësinë.
4. Celula dhe grupe komuniste u hapën në Shqipëri përpara shpërbërjes së Grupit Komunist Shqiptar të BRSS-së dhe ardhjes së antarëve të tyre në Shqipëri (1930).